



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
Sekretaria

Nr. Prot.

Tiranë, më .11.2024

**MBLEDHJA Nr. 47,**  
**Datë 18.11.2024, ora 09:00**  
**e Bordit të ERE-s**

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funkcionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Hënë, datë 18.11.2024, ora 09:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 47 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së Bordit të ERE-s më datë 14.11.2024.
2. Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e planit të investimeve të shoqërisë OST sh.a. për periudhën rregullatore 2025 – 2027.
3. Mbi pezullimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të kërkesës për miratimin e planit dhjetëvjeçar të investimeve nga shoqëria ALBGAZ sh.a., të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 293, datë 12.10.2023, mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës për miratimin e planit dhjetëvjeçar të investimeve nga shoqëria ALBGAZ sh.a.
4. Mbi kërkesën e shoqërisë “MOUNTAIN’S GREEN ENERGY” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën [erealb@ere.gov.al](mailto:erealb@ere.gov.al), jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**